



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Drenas shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të inxhinierisë të Ndërtimit
Institucioni	Komuna Drenas
Nr. i Referencës	RN00007894
Kodi	RPC0001701
Data e njoftimit	18.11.2021
Afati për aplikim	09.12.2021 - 20.12.2021

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Inspektimi rreth lejeve të ndërtimit në zbatim të Ligjit, udhëzimeve administrative dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me ndërtimin;
2. Inspektimi rreth kushteve të ndërtimit dhe lejeve urbanistike;
3. Inspektimi i zbatimit të planit urbanistik;
4. Inspektimi i fazave të ndërtimit në harmoni me lejen e ndërtimit;
5. Kontrollimi i dokumentacionit tekniko-investues në bazë të cilit është dhënë leja e ndërtimit;
6. Ndalimi i ndërtimeve pa leje (procesverbalet, vendimet për ndërprerje të punimeve, mbyllja e vendndërtimit, largimi i personelit nga vendndërtimi);
7. Nxjerja e vendimeve për rrënimin e objekteve pa lejeRrënimi i objekteve pa leje;
8. Marrja e masave për shkelësit e Ligjit (shqiptimi i gjobave dhe iniciimi i fletë paraqitjeve kundërvajtëse në Gjykatë dhe të kallëzimeve penale ne Prokurori);
9. Kryerja e punëve administrative në Drejtori.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë të studimeve Universitare më të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor)

Fakulteti i Ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv, hidro dhe arkitekturë

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0001501	RN00007681	Inspektor i Ndërtimit	Profesional 1	7	Komuna Drenas	Sektori i Përgjithshëm / Drejtoria e Inspektionit

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë



9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Kandidatët vlerësohen për njohuritë, aftësitë dhe cilësitë kryesore të domosdoshme të kërkuara lidhur me pozitën e shpallur;
- Vlerësimi i jetëshkrimit konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës;
- Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim;
- Vlerësimi i njohurive të vendit të punës bëhet bazuar në Ligjin e Ndërtimit dhe Rregullore të aplikueshme që lidhen me fushën e ndërtimit.

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen